


PAVARĒSIA



DEMOKRACIA DHE ZHVILLIMI I SAJ

LUAN (10), LEONARD (10), LIND (10), ARTIOL (11), OLEANDRDA (10), VESA (10), ALVISA (10),

FLUTRA (9)



Ne e zhvillojmë demokracinë, demokracia na zhvillon neve

Demokracia është formë e qeverisjes, që nënkupton të drejtën e barabartë të çdo qytetari për të marrë pjesë në vendimmarrje.

Tiparet apo elementet kryesore të demokracisë janë: liria, barazia, respektimi i të drejtave të njeriut, toleranca, bashkëpunimi, drejtësia etj.

Një ndër elementet kryesore të demokracisë është edhe respektimi i të drejtave të njeriut. Ato të drejta janë e drejta për të jetuar, e drejta e të pasurit emër, e drejta e punësimit, e drejta e shkollimit, e drejta e strehimit, e drejta për t'u ushqyer, e drejta për t'u argëtuar etj.

Demokracia funksionon me anë të zgjedhjeve. Zgjedhjet luajnë rol vendimtar në demokraci.

Fjala demokraci për herë të parë është përdorur në Greqinë antike në shekullin e V para erës së re.

Fjala demokraci rrjedh nga fjala "demos" që do të thotë popull dhe "kratia" që do të thotë pushtet. Sipas këtyre dy fjalëve greke, demokraci në gjuhën shqipe i bie që është pushteti i popullit. Demokracia në atë kohë nuk ishte shumë e zhvilluar. Me kalimin e viteve demokracia është zhvilluar shumë.

Në shtetet demokratike qytetarët gëzojnë të drejtat e barabarta pa dallim feje, race, moshe, besimi apo bindje. Ka dy forma kryesore të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy forma, në demokraci parlamentare dhe demokraci presidenciale. Republika e Kosovës ka demokraci parlamentare. Të gjithë duhet të kontribuojmë që ta forcojmë demokracinë në vendin tonë.

Shteti na ka ndihmuar me shkollim për shumë vite, kurse ne kur të rritemi do t'ia kthejmë të mirat duke punuar secili në profesionet e veta.



Gazetarët duke punuar për artikull



Gazetarët e rinjë

ZGJEDHJET FORMË E DEMOKRACISË


BLIN (10), JONI (10), OLISA (10), ANETA (10), ALBION (10), MJELMA (11), REARD (10)

Fëmijët shprehin mendimet e tyre rreth procesit zgjedhor në një shtet demokratik


Zgjedhjet janë shumë të rëndësishme sepse me anë të tyre, populli do të vendosë për të ardhmen e vendit. Në zgjedhje secili qytetar ka të drejtë të votoj një përfaqësues që mendon se është më i miri. Ne bëjmë shumë zgjedhje në jetën e përditshme, për shembull zgjedhjen e kryetarit të klasës, por të drejtën për të marrur pjesë në zgjedhjet shtetërore e kemi pasi të mbushim moshën 18 vjeçare. Në këtë moshë, jemi më të pjekur dhe e dimë se kë duhet ta votojmë si përfaqësuesin tonë. Është shumë e rëndësishme që përfaqësuesit të jenë të drejtë dhe ta përfaqësojnë popullin në mënyrën më të mirë të mundshme. Votimi bën ndryshimin, prandaj secili qytetar i Republikës së Kosovës duhet të votoj dhe mesazhi ynë është: voto edhe ti për një të ardhme sa më të mirë.



Ardhmëria e vendit



Ne duam të jetojmë në një shtet demokratik



Informacionet tona për zgjedhjet



Procesi i votimit



Vota jote ka vlerë të madhe

ZËRI I POPULLIT

ANDI (11), BLENDI (10), EDIONA (10), ERJONI (10), GJINI (11), LEARTI (10), LEONITA (10)



Kuvendi është Shtëpia e Popullit

Ne e dimë që demokracia ndryshe është e njohur si udhëheqja e popullit. Pse themi se është udhëheqja e popullit?

Sepse populli është ai i cili i zgjedh përfaqësuesit e vet. Vendi ynë është vend demokratik dhe ka demokraci përfaqësuese. Përfaqësuesit ndryshe ne i njohim si deputetë. Këta deputetë punojnë në Kuvend dhe kanë shumë detyra dhe përgjegjësi. Kushtetuta për-



cakton detyrat dhe përgjegjësitë e deputetëve si dhe punët në tërësi të Kuvendit, duke përfshirë këtu edhe strukturën e Kuvendit si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera. Kuvendi i Kosovës, është institucioni më demokratik sepse zgjedhet direkt nga populli. Këta deputet kanë për detyrë që t'i përfaqësojnë interesat e popullit. Përveç përfaqësimit të popullit po ashtu funksion tjetër i Kuvendit është mbikëqyrja e Qeverisë si dhe miratimi i ligjeve. Këto ligje në fillim njihen si

projektligje të cilat mund të propozohen nga deputetët, nga një numër i madh i qytetarëve, Presidenti si dhe nga Qeveria. Pasi projektligjet të propozohen, Kuvendi i shqyrton ato dhe nëse këto ligje janë në të mirën e popullit atëherë Kuvendi i voton dhe kalojnë në ligje. Për të votuar një projektligj, Kuvendi përdor dy mënyra në lidhje me votimin e projektligjit.

Ato janë: votimi me shumicë të thjeshtë që duhet 21 prej tyre të votojnë pro atij projektligji, si dhe me shumicë të kualifikuar që duhet të votojnë 81 deputetë për tu miratuar projektligji. Këto ligje Kuvendi ia dërgon Qeverisë për t'i zbatuar ato. Në këtë formë Kuvendi përmes seancave plenare që i mban çdo javë e mbikëqyr Qeverinë duke parashtruar pyetje ministrave të pranishëm në seancë. Kuvendi i Kosovës ka gjithsej 120 deputetë. Prej tyre, 20 janë të komuniteteve jo shumicë ndërsa 100 të tjerë janë të komunitetit shqiptar. Të gjithë këta deputetë punojnë për të mirën e popullit.



Autorët e artikullit

NE NDIKOJMË NË ARDHMËRINË TONË

FLORID (10), FLETA (10), ERA (10), JONA (10), ISLAM (10), OLTİ (10), ANDI (10), OLTA (10)

Qytetarë të përgjegjshëm

Qytetarët aktiv, ku bëjnë pjesë edhe fëmijët, janë ata të cilët kontribuojnë për vendin e tyre. Qytetarët aktiv mund të angazhohen në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Disa nga hapat që mund të ndërmerren për pastrimin e ambientit në nivel lokal janë:

- Të mbledhen mbeturinat dhe të hudhen në shportat e mbeturinave.
- Të mbledhen para për të realizuar hapësira të ricikleshme për mbeturina të llojllojshme.
- Të vetëdijësohen qytetarët për ndikimin e keq që ka ndotja e ambientit tek shëndeti i tyre.

Për tu realizuar këto hapa duhet të jemi të përgjegjshëm për rëndësinë e ruajtjes së ambientit.



Gazetarët e vegjël



Puna jonë në grup



Një ambient me ajër të pastër



Qytetarët duhet të jenë tolerant ndaj njëri-tjetrit



Qytetarët aktiv votojnë në proceset zgjedhore



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrur pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pavarësia“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë